



QRR (ISO Trade &

Inv.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JOANA M. KUSHE
ADRESA NR.9, RR. E BARRIKADAVE,
NR.118, NR.5, NR.6
TEL: 692054031

KONTRATË SHKËMBIMI

(PËR PASURI TË LUAJTSHME)

Nr. repertori: 42

Nr. koleksioni: 8

Tirane më 29/01/2024

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2024053180001274858



A2024053180001274858

KONTRATË SHKËMBIMI

(Pasuri e luajtshme)

Sot, më datë _____, para meje Notere JOANA M. KUSHE, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, RR. E BARRIKADAVE, NR.118, NR.5, NR.6, u paraqit personalisht:

PALA

1(SHKEMBYESE):

Ardian Margjini, atësia Mark, amësia Rutë, shtetas Shqiptar, lindur në Bulshar, Mirditë dhe banues në Tiranë, me adresë Bajram Curri; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 4; Njesia Bashkiake Nr. 4; 0000; Tiranë, lindur më 30/07/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 030105727 dhe nr. personal H20730054R, .

Dhurata Margjini, atësia Mark, amësia Gjellë, shtetase Shqiptare, lindur në Kurbnesh, Mirditë dhe banuese në Tiranë, me adresë Rr Bajram Curri; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 4; Njesia Bashkiake Nr. 4; 0000; Tiranë, lindur më 29/04/1974, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 038681470 dhe nr. personal H45429056I

PALA

2(SHKEMBYESE):

Gezim Lika, atësia SHEFQET, amësia Fatbardha, shtetas Gjerman, lindur në LUSHNJE dhe banues me adresë 74172 NECKARSULM SONNENHALDE 7, Gjermani, lindur më 06/08/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 810288 dhe nr. personal L8JGLVMM, .

Olga WELKER - LIKA, atesia Albert, Amesia IRENE, shtetase Gjermane, lindur ne Komsomolskij, dhe banuese ne adrese 74172 NECKARSULM SONNENHALDE 7, Gjermani, lindur më 17.04.1980, gjendja civile "e martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 481055 dhe nr. personal L8JG562CG

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 83, 705, 757, 760 e vijues i tij, ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja hartimin e Kontratës së Shkëmbimit – pasurive te luajtshme, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:



A2024053180001274858

KUSHTE TE PERGJITHSHME

Rezulton nga "Ekstrakti I regjistrit tregtar per te dhenat e subjektit", gjeneruar nga e- Albania, nenshkruar elektronikisht nga QKB me date 26.01.2024 se :

Pala 1 shkembyese, Ardian Margjini, ne cilesine e Ortakut te Vetem, ka ne pronesi 100 % te kapitalit ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar EVISION sh.p.k., rregjistruar prane QKB me date 03.04.2023 dhe pajisur me NUIS M31603002U, me status *Aktiv*

Pala 2 shkembyese, Gezim Lika, ne cilesine e Ortakut te Vetem, ka ne pronesi 100 % te kapitalit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te emertuar ISO Trade & Invest, rregjistruar prane QKB me date 21.07.2015 dhe pajisur me NUIS L51823004I, me status *Pezulluar*.

Bazuar ne Rezultatet e Kerkimit leshuar nga RBS me date 26.01.2024, ne lidhje me gjendjen juridike te kuotes qe disponon secila nga palet ne shoqerite respective, rezulojne se ato jane te lira nga cdo barre, hipoteke apo detyrim tjetër.

Megenese, palet kane rene dakort me njera tjetren, qe pala 1 shkembyese te transferoje 1 kuote qe perfaqeson ne perqindje 50% te vleres se kapitalit te shoqerise EVISION te pala 2 shkembyese, dhe pala 2 shkembyese te transferoje 1 kuote qe perfaqeson ne perqindje 50% te vleres se kapitalit te shoqerise ISO Trade& Invest te pala 1 shkembyese, si dhe duke qene se vlera e ketyr kuotave eshte e njejte, kane vendosur qe transferiumi I tyre te behet nepermjte kesaj kontrate shkembimi, duke parashikuar keto te drejta dhe detyrime.

PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

Shkembimi i 1 kuote qe perfaqeson 50% te vleres se kapitalit te shoqerise EVISION sh.p.k., me 1 kuote qe perfaqeson 50% te vleres se kapitali themeltar te shoqerise ISO Trade & Invest sh.p.k., nepermjet kalimit te te drejtave te pronesise midis pronareve te ligjshem te tyre, paleve ne kete kontrate.

Ne kushtet kur, kuotat qe shkembehen kane te njejten vlere me njera tjetren, **nuk kemi kompesime ne para apo ne natyre.**

Baza Ligjore:

Neni 757-760 të Kodit Civil

Neni 62, pika 1, gërma "II", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

Kodi i Familjes, nenet 73, 74/a e vijues;

Ligji 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", nenet 105/3, 105/4, 105/5 neni 127 e vijues;

Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"



A2024053180001274858

Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar

DETYRIMET E PALEVE

- palet garantojnë njeri tjetrin se janë pronare të ligjshëm të pasurive objekti kësaj kontrate.
- Palet garantojnë njeri tjetrin se pasuritë që shkëmbehen nuk kanë të meta të fshehta.
- Palet garantojnë njeri tjetrin nga çdo pretendim pronësi e personave të tretë (e drejta e eviksionit).
- Palet garantojnë njeri tjetrin se mbi pasuritë e paluajtshme objekti kontratës, nuk rëndon asnjë barrë ose e drejtë tjetër reale e personave të tretë.
- Detyrimet mbi këtë pasuri ndaj shtetit ose çdo personi tjetër deri në ditën e dorëzimit të saj, janë në ngarkim të paleve.

EFEKTET E NENSHKRIMIT TE KONTRATES

- Efektet e kalimit të pronësive midis paleve fillojnë menjëherë me nënshkrimin e kesaj Kontrate.
- Me nënshkrimin e kontratës:

Pala 1 shkëmbyese Z. Ardian Margjini është zoterues i 1 kuote që përfaqëson 50% të vlerës së kapitalit të shoqërisë EVISION sh.p.k. dhe zoterues i 1 kuote që përfaqëson vlerën 50% të kapitalit të shoqërisë ISO Trade & Invest sh.p.k.

Pala 2 shkëmbyese, z. Gezim Lika, është zoterues i 1 kuote që përfaqëson 50% të vlerës së kapitalit të shoqërisë EVISION sh.p.k. dhe zoterues i 1 kuote që përfaqëson vlerën 50% të kapitalit të shoqërisë ISO Trade & Invest sh.p.k.

Ngarkohet Znj. Anisa Dedi, administratorja e shoqërisë EVISION sh.p.k, të bëjë regjistrimin e kesaj kontrate për secilen shoqëri pranë OKB.

ZGJIDHJA E KONTRATËS

Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim ose ndërmjetësim, secila prej tyre mund t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor kompetente.

ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneks të Kontratës.

Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.



A2024053160001274858

Ekstraket historike te shoqerive (2 cope) ;

Rezultata e kerkimit leshuar nga RBS (2 cope)

Kontrata e Shkëmbimit pasuri e luajtshme, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALA 1(SHKEMBYESE)

Ardian Margjini

PALA MIRATUESE NË AKT

Dhurata Margjini

PALA 2(SHKEMBYESE)

GEZIM LIKA

PALA MIRATUESE NË AKT

OLGA WELKER- LIKA

NOTER

JOANA M. KUSHE

Kuptoj shqip